

D E K R E T
Nr.7476, datë 12.3.1991

PËR LEJIMIN DHE MBROJTJEN E PRONËS E TË VEPRIMTARIVE PRIVATE

Në mbështetje të nenit 78 të Kushtetutës;
Me propozimin e Këshillit të Ministrave;

PRESIDIUMI I KUVENDIT POPULLOR
TË REPUBLIKËS POPULLORE
SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

V E N D O S I :

Neni 1

Në Republikën Popullore Socialiste të Shqipërisë lejohet dhe mbrohet prona dhe veprimtaria private.

Neni 2

Ndërmarrjet ose institucionet dhe njësitë e tjera shtetërore, si në fushën e prodhimit industrial, artizanal, të bujqësisë, ndërtimit, transportit, të shërbimeve bankare, të tregtisë së brendshme e të jashtme, të komunales, të shërbimeve jetësore, shkencore, kulturore e artistike lejohen të kalojnë në pronësi private, sipas kriterëve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 3

Ndërmarrjet dhe njësitë e tjera shtetërore në degët strategjike të ekonomisë kombëtare si industria e energjitikës, e mineraleve, e naftës dhe e gazit natyror, postat, telekomunikacionet, pyjet dhe ujërat, rrugët automobilistike, hekurudhore, portet detare, aeroportet, transporti hekurudhor e ajror mbeten pronë shtetërore. Në raste tepër të veçanta ndonjë objekt mund të kalojë në pronësi private vetëm me ligj.

Neni 4

Për të organizuar, drejtuar e bashkërenduar procesin e kalimit të pronës shtetërore në pronë private në shkallë vendi, krijohet Komiteti i Riorganizimit të Ekonomisë në vartësi të Këshillit të Ministrave.

Neni 5

Veprimtaritë private organizohen dhe funksionojnë:

- a) si individë;
- b) me ortakëri;
- c) me kolektiva ose kooperativa
- ç) ndërmarrje e shoqëri aksionare.

Neni 6

Ndërmarrjet shtetërore ose organizatat shoqërore mund të formojnë ndërmarrje të

përbashkëta me subjekte të përcaktuara në nenin 5 të këtij dekreti.

Neni 7

Subjektet e përcaktuara në nenet 5 e 6 të këtij dekreti lejohen të krijojnë shoqëri ose ndërmarrje të përbashkëta me persona fizikë a juridikë të huaj, me miratim të organeve përkatëse të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Neni 8

Personat fizikë dhe juridikë privatë vendas a të huaj e bazojnë dhe e zhvillojnë veprimtarinë e tyre ekonomike e financiare me blerjen e pasurisë shtetërore me mjetet e tyre financiare, me kredi dhe me aksione ose me qira.

Neni 9

Në raste të veçanta, sipas kritereve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, ndërmarrjet dhe njësitë e tjera shtetërore me mjete themelore të amortizuara fizikisht ose moralisht dhe kur janë pa rentabilitet ose me humbje, lejohet t'u kalojnë në pronësi private me kushte lehtësuese personave fizikë e juridikë me shtetësi e me banim në Shqipëri, me qëllim vazhdimësinë e veprimtarisë ekonomike.

Neni 10

Autorizimi për privatizimin e ndërmarrjeve e të njërive shtetërore jepet nga ministrinë përkatëse, pasi merret pëlqimi nga Komiteti i Riorganizimit të Ekonoimisë.

Rregulla të hollësishme për zbatimin e privatizimit caktohen me dispozita të veçanta.

Neni 11

Subjektet e përmendura në nenet 5, 6, 7 të këtij dekreti fitojnë zotësinë për të vepruar si person juridik me regjistrimin e tyre në gjykatë. Ata nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre pa u regjistruar në organet financiare.

Neni 12

Çmimet dhe tarifat e prodhimeve e të shërbimeve caktohen nga personat fizikë a juridikë privatë, në bazë të kërkesës e të ofertës.

Për disa mallra e shërbime të rëndësishme, ku sigurohet pozita e monopolit, caktohen kufijtë maksimalë të çmimeve e tarifave nga organet shtetërore, sipas kompetencave përkatëse.

Neni 13

Tatimet e taksat për veprimtarinë ekonomike që realizohet nga personat fizikë ose juridikë privatë, janë me karakter stimulues sipas veprimtarisë dhe në funksion të dobisë shoqërore të tyre.

Neni 14

Toka nuk tjetërsohet. Marrëdhëniet e shtetit me personat privatë për përdorimin e tokës rregullohen me kontratën e qirasë, sipas dispozitave në fuqi.

Neni 15

Marrëdhëniet e punës në veprimtarinë private rregullohen me kontratën që lidhet ndërmjet palëve në përputhje me legjislacionin e punës.

Neni 16

Në veprimtaritë private punonjësit sigurohen në mënyrë të detyrueshme nga punëdhënësi dhe përfitojnë të drejta në bazë të ligjit mbi sigurimet shoqërore shtetërore.

Neni 17

Për punonjësit që mund të dalin të tepërt nga procesi i privatizimit të sektorit shtetëror, shteti bën trajtimin e tyre me ndihmën sociale të parashikuar me dispozita të veçanta.

Neni 18

Vlerësimi i fondeve që do të privatizohen, bëhen sipas vleftës fillestare, gjendjes fizike reale, vendodhjes së tyre, karakterit të shërbimit, kërkesës dhe ofërtes, duke zbatuar për objektet e vogla edhe formën e shitjes në ankand, kurse vlerësimi dhe shitja e mjeteve xhiruese bëhet me çmimet shtetërore me pakicë në fuqi.

Neni 19

Mërrëdhëniet e debitorëve e të kreditorëve shtetërorë a private që rezultojnë në momentin e kalimit të pronësisë së ndërmarrjes ose të njësisë në pronë private, zgjidhen në marrëveshje ndërmjet palëve.

Neni 20

Personat fizikë a juridikë privatë, për kryerjen e veprimtarisë së tyre, bazën materiale teknike e sigurojnë sipas rastit nëpërmjet kontratave me sektorin shtetëror përkatës, drejtpërdrejtë në tregun e lirë, si dhe nga personat fizikë a juridikë të huaj, sipas legjislacionit në fuqi për eksport-importin.

Mjetet e prodhimit, lëndët e para e materiale, energjia elektrike etj, u faturohen personave privatë nga ndërmarrjet përkatëse me çmimet e shitjes me pakicë, kurse për blerjet jashtë sektorit shtetëror çmimet caktohen në bazë të kërkesës e të ofertës.

Neni 21

Personat fizikë a juridikë privatë, për kryerjen e veprimtarisë mbajnë kontabilitet sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 22

Për shkeljen e rregullave të parashikuara në nenet 7, 11, 21 të këtij dekreti, kur nuk formojnë vepër penale, personat fajtorë dënohen për kundërvajtje administrative me gjobë nga 500, deri në 1000 lekë.

Të drejtën e gjobës e kanë, përveç organeve të policisë financiare edhe drejtoritë përkatëse në ministritë dhe institucionet e tjera qendrore.

Ankimi kundër vendimit të dënimit me gjobë mund të bëhet, brenda 10 ditëve nga data e

njoftimit, te ministri ose drejtuesi i institucionit tjetër qendror, akti i të cilëve është i formës së prerë.

Neni 23

Rregulla të hollësishme për zbatimin e këtij dekreti caktohen me dispozita të Këshillit të Ministrave.

Neni 24

Dispozitat që bien në kundërshtim me këtë dekret, shfuqizohet.

Neni 25

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PËR PRESIDIUMIN E KUVENDIT
POPULLOR TË REPUBLIKËS
POPULLORE SOCIALISTE TË SHQIPËRISË

SEKRETARI
SIHAT TOZAJ

KRYETARI
RAMIN ALIA